



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Nr. 2025 prot.

Elbasan, më 30.09.2021

UDHËZIM

"Për mënyrën e implementimit të marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+KA10 7 International Credit Mobility"

Në mbështetje të nenit 89 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr 117/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin ERASMUS +, programi i BE-Së për arslmin, trajnimin, rininë dhe sportin", nenit 58 të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për mënyrën e implementimit të marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA 107 International Credit Mobility, për vitin akademik 2021-2022,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të jetë struktura e cila merret me organizimin administrativ të mobiliteteve, duke përfshirë:

- Hartimin dhe publikimin e thirrjeve për mobilitete sipas marrëveshjes si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga universiteti partner;
- Mbarëvajtjen e procesit të drejtë dhe transparent mbi aplikimin, përzgjedhjen dhe nominimin e kandidatëve fitues;
- Komunikimin me studentët, personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UE-së dhe universitetin partner.

2. Bazuar në marrëveshjen ndërinstitucionale dypalëshe midis Universitetit partner dhe UE-së, të përcillen të dhënat si më poshtë:

- Numri dhe lloji i mobiliteteve (hyrëse dhe dalëse) të financuara për t'u realizuar mes institucioneve;
- Fusha dhe cikli i studimeve në të cilat do të implementohet marrëveshja.
- Periudha e mobilitetit;
- Afati i pranimeve të aplikimeve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" REKTORATI

- Informacione që lidhen me procedurën e përzgjedhjes, dokumentat e nevojshme për aplikim (në rast se universitetet partnere kanë modalitetet e tyre).
 - Detaje financiare mbi dietën ditore, bursën mujore, mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, mbështetjen organizative.
3. Thirrja për mobilitete për studentë dhe staf për mësimdhënie, të hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze, sipas formatit bashkëlidhur. (shtojca nr. 1 dhe 2).
4. Kriteret e përzgjedhjes së studentëve të konsistojnë, por duke mos u kufizuar në:
- Kompetencat gjuhësore;
 - Merita akademike;
 - Përparësi ti jepet studentëve të cilët aplikojnë për herë të parë.
5. Studentët mund të jenë përfitues të mobilitetit, vetëm një herë gjatë një cikli studimesh.
6. Kriteret e përzgjedhjes së personelit akademik për mësimdhënie, të konsistojnë, por duke mos u kufizuar në:
- Kompetencat gjuhësore në gjuhë të huaj, sipas përcaktimit në marrëveshjen e bashkëpunimit;
 - Përparësi kanë personelet nga fushat prioritare të programeve të studimit;
 - Përparësi kanë personelet të cilët aplikojnë për herë të parë.
7. Kriteret e përzgjedhjes së personelit ndihmës akademik dhe administrativ të konsistojnë, por duke mos u kufizuar në:
- Kompetencat gjuhësore në gjuhë të huaj, sipas përcaktimit në marrëveshjen e bashkëpunimit;
 - Strategjisë së institucionit dhe prioriteve të tij.
8. Vlerësimi i aplikimeve të realizohet nga komisioni i vlerësimit në nivel institucioni me përbërje si më poshtë:
- Komisioni i vlerësimit për aplikimet e studentëve:
 - Përfaqësues i departamentit/ departamenteve të gjuhëve të huaja;
 - Zv.Rektori/ Dekan i Fakultetit ku studenti bën pjesë/ Drejtuesi i Departamentit ku studenti bën pjesë/ Personel akademik i Fakultetit ku studenti bën pjesë ;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

- Specialist i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë.
- Komisioni i vlerësimit për aplikimet e personelit akademik dhe ndihmës akademik:
 - Rektori;
 - Zv. Rektori;
 - Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
- Komisioni i vlerësimit për aplikimet e stafit administrativ:
 - Rektori;
 - Administratori;
 - Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

9. Në çdo rast, pas konfirmimit të institucionit partner, lista e mobiliteteve të konfirmuara për studentët dhe stafin akademik ti bëhen me dije strukturave të Rektoratit dhe njërive kryesore.

10. Në çdo rast, periudha e mobilitetit për studentët dhe personelin e huaj të certifikohet përmes një dokumenti që konfirmon mobilitetin, datën e fillimit dhe përfundimit të tij dhe aktivitetet e kryera, sipas shtojcave bashkëlidhur (shtojca nr.3, 3.1 dhe nr. 4).

11. I gjithë dokumentacioni i aplikimit dhe dokumentacioni pas realizimit të mobilitetit, përfshirë të dhënat mbi grantet e përfituara, të ruhet nga Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe një kopje e dokumentacionit arshivohet.

12. Periudha e mobilitetit për studentët, ti nënshtrohet parashikimit ligjor, nënligjor dhe akteve të brendshme të UE-së mbi njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit.

13. Periudha e mobilitetit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, të raportohen sipas formatit të raportimit të aktiviteteve bashkëlidhur. (shtojca nr.5).

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr Skender TOPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Shtojca nr. 1

Hapet thirrja për aplikim për mobilitetin e studentëve në Universitetin e _____ / Call for applications for student mobility at University _____.

Ju njoftojmë se është hapur thirrja për aplikim për bursa studimi për semestrin e _____ për _____ studentë, në kuadër të projektit International Credit Mobility (Erasmus+) të fituar nga Universiteti ynë në bashkëpunim me Universitetin _____. Ftohen të aplikojnë të gjithë studentët e interesuar të Fakultetit _____, të programeve të studimit _____.

We kindly inform all the students that the call for _____ applications within the International Credit Mobility Erasmus +, is opened. University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani" in cooperation with University _____, is pleased to invite all the interested students of the Faculty _____, study program _____ to apply.

Detaje të mobilitetit: / Mobility details:

Periudha e mobilitetit do të zhvillohet gjatë semestrit të _____, të vitit akademik _____ me një kohëzgjatje prej _____ muajsh. Studentët fitues do të përfitojnë një bursë mujore në masën _____ si dhe rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit në masën _____, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e mobilitetit.

The mobility period will take place during the _____ semester of the academic year _____, with a duration of _____ months. The nominated students shall receive a monthly grant _____, as well as reimbursement of travel expenses _____, as specified in the mobility agreement.

Dokumentet e nevojshme për aplikim: / Documents required for application:

1. Fotokopje e pasaportës / Photocopy of passport
2. Vërtetim që jeni student i UE-së / Confirmation certificate that you are an EU student
3. Certifikata e gjuhës angleze (niveli _____) / English Language Certificate (level _____)
4. CV në anglisht / CV in English
5. Formulari i aplikimit/ Application form : [Erasmus+students_application_form.pdf](#)

Dokumentacioni i sipër kërkuar, duhet të dorëzohet personalisht, pranë Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ose mund të dërgohen në adresën e e_mail : info@uniel.edu.al

The above required documentation should be submitted personally to the Directorate of Coordination and International Relations at the Rectorate of the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani" or can be sent to the e-mail address: info@uniel.edu.al

Afati i fundit për aplikim është data _____! / The deadline for application is _____!

Ju urojmë suksese! / Best of luck!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Shtojca nr. 2

Hapet thirrja për aplikim për mobilitetin e stafit akademik (teaching/training), në Universitetin e _____ / Staff Mobility Call for (teaching/training) at University _____.

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ka kënaqësinë, që në kuadër të International Credit Mobility (Erasmus+) të fituar nga Universiteti ynë në bashkëpunim me Universitetin _____, fton stafin akademik (teaching/training) nga _____ të aplikojnë.

University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", in cooperation with University _____, within the international Credit Mobility (Erasmus +), is pleased to invite academic/administrative staff for (teaching training) from _____ to apply.

Detaje të mobilitetit / Mobility Details

Periudha e mobilitetit do të zhvillohet gjatë vitit akademik _____ me një kohëzgjatje prej _____ ditësh. Pesoneli fitues do të përfitojnë një dietë ditore dhe rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e mobilitetit.

The mobility period will take place during the academic year _____ with duration of _____ days. The selected staff shall receive a grant that covers individual support and travel expenses, as defined in the mobility agreement.

Dokumentet e nevojshme për aplikim / Documents required for application

1. CV në anglisht / CV in English
2. Kopje e Pasaportës / Copy of Passport
3. Letër Motivimi në gjuhën Angleze / Motivation letter in the English language
4. Certifikatë e gjuhës Angleze (niveli B2) / Certificate of English language (level B2)
5. Plani i mobilitetit për teaching/training. (TA) / Mobility plan for teaching/training. (TA)

Dokumentacioni i sipër kërkuar, duhet të dorëzohet personalisht, pranë Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" ose mund të dërgohen në adresën e e_mail : info@uniel.edu.al

The above required documentation must be submitted personally to the Directorate of Coordination and International Relations at the Rectorate of the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani" or can be sent to the e-mail address: info@uniel.edu.al.

Afati i fundit për aplikim është data _____! / The deadline for application is _____!

Ju urojmë suksese! / Best of Luck!



ERASMUS+ CERTIFICATE OF ATTENDANCE

We hereby confirm that Mr/Ms. _____, student at University of _____, during the _____ semester of the academic year _____, has participated in Erasmus+ Programme at the University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani", Department of _____, Faculty _____, Elbasan, Albania.

This document is issued as she/he has fulfilled all obligations.

Elbasan _____

Dean of _____





UNIVERSITY of
ELBASAN
"Aleksandër Xhuvani"

CERTIFIKATË FREKUENTIMI ERASMUS+

Me anë të kësaj certifikate konfirmojmë që z/znj. _____, student/e pranë Universitetit të _____, për semestrin e _____ të vitit akademik _____, ka marrë pjesë në programin e shkëmbimit Erasmus+, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Departamenti i _____, Fakulteti _____, Elbasan, Shqipëri.

Lëshohet ky dokument në përmbushje të të gjitha detyrimeve të tij/saj.

Elbasan

DEKANI



Erasmus+

ERASMUS+ CERTIFICATE OF ATTENDANCE

This certificate goes to


From “_____”, has successfully accomplished the ERASMUS+ Mobility for Teaching (KA107), at **University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani”**, Elbasan, **Albania**, during the period of _____.

I confirm that all teaching requirements have been carried out.

Elbasan

___/___/2021

**Rector of the University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani”
Prof.dr. Skender TOPI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

FAKULTETI _____
DEPARTAMENTI _____



Erasmus+

RAPORT VEPRIMTARIE

Training/Teaching activity of _____ at _____,
from _____.____.____ to _____.____.____

<i>Të përshkruhen në vijim llojet e aktiviteteve të ndjekura, gjatë mobilitetit Erasmus+ teaching/training.</i>	
<i>Të specifikohet (ose të bashkëlidhet) axhenda e aktiviteteve dhe takimeve të realizuara në institucionin pritës.</i>	
<i>Të paraqitet një listë e kontakteve të personave të takuar gjatë mobilitetit, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve në vijim.</i>	

Emër Mbiemër
Firmë